

**VENDIM**  
**Nr.4, datë 19.4.2011**

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDEVE TË ZHVILLIMIT TË RAJONEVE PËR  
PROJEKTET E ARSIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Financimin prej 947 580 801 (nëntëqind e dyzet e shtatë milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind e një) lekësh, pjesë e fondit të buxhetit të vitit 2011 për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, për projektet e reja për arsimin të aplikuara nga njësitë e qeverisjes vendore dhe universitetet si më poshtë vijon:

- Vlerën prej 658 668 712 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) lekësh për projektet e arsimit bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe arsimit të mesëm profesional, specifikuar sipas listës nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Vlerën prej 31 847 466 (tridhjetë e një milionë e tetëqind e dyzet e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh për pajisje, specifikuar sipas listës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Vlerën prej 215 640 000 (dyqind e pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet mijë) lekësh për projektet e arsimit të lartë, specifikuar sipas listës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Vlerën prej 41 424 623 (dyzet e një milionë e katërqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e njëzet e tre) lekësh për bashkëfinancimin e projekteve me financim nga PNUD-i, dhënë me hollësi sipas vendimit nr.3, datë 11.3.2011 të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve.

2. Ngarkohet Ministria e Financave të kryejë veprimet për bërjen efektive të fondeve.

**KRYETARI**  
**Sali Berisha**